

**Njoftim përqendrimi me të cilin ALFI RE menaxhim i fondeve të investimeve alternative, d.o.o., Slloveni dhe ERSTE d.o.o. – shoqëri për promovimin e fondeve të pensioneve të detyrueshme dhe vullnetare, Kroaci do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi një pjesë të ndërmarrjes Lajthaus Investments, investime në pasuri të paluajtshme d.o.o. Slloveni**

**(lënda nr. 08-112/2024)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 31.07. 2024, ndërsa e plotësuar më 06.08.2024, 07.08.2024 dhe 13.08.2024, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin ALFI RE menaxhim i fondeve të investimeve alternative, d.o.o., me seli në rrugën Verovshkova 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni dhe ERSTE d.o.o. - shoqëri për promovimin e fondeve të pensionit të detyrueshëm dhe vullnetar, me seli në Ivana Luçiqja 2a, 10000 Zagreb, Kroaci në emër të tyre dhe në llogari të ERSTE PLAVI FONDIT TË DETYRUAR TË PENSIONIT TË KATEGORISË B me seli në Ivana Luçiqja 2A, 10000 Zagreb, Kroaci do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi një pjesë të ndërmarrjes Lajthaus Investments, investime në pasuri të paluajtshme d.o.o, Koper, Ankaranska cesta 2, 6000 Koper – Kapodistria, Slloveni përmes disa transaksioneve të ndërlidhura dhe të varura që përfshijnë blerjen e mjeteve.

Qëllimi i Fondit ALFI RE është të gjenerojë kthime për investitorët nëpërmjet investimeve në pasuri të paluajtshme komerciale. Fondi investon në një portofol të pasurive të paluajtshme komerciale dhe zyra, logjistike dhe qendra mjekësore.. Qëllimi i vetëm i Fondit është të investojë mjetet e mbledhura nga investitorët në përputhje me politikën e investimeve në një portofol të disa pronave me qëllim të diversifikimit të rreziqeve, dhe në të njëjtën kohë menaxheri i Fondit siguron gjithashtu menaxhimin dhe mirëmbajtjen profesionale të pronës nëpërmjet kontraktorëve të përzgjedhur me kujdes.

**Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit**

Veprimtaria e regjistruar e ALFI RE është: aktivitetet e menaxhimit të fondeve.

Grupi ALFI aktualisht ka 1 shoqëri të lidhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut: Shoqëria për Tregti dhe Shërbime APOLLO MK SHPKNJP Shkup me NUAS 6577857 me seli në bul.. Kiro Gligorov nr. 13 Shkupi me aktivitet prioritar 46.49 – tregtia me shumicë me mallra të tjera për amvisëri

Veprimtaria e regjistruar e ERSTE d.o.o. - Shoqëria për promovimin e fondeve të pensionit të detyrueshëm dhe vullnetar është menaxhimi i fondeve të pensionit të detyrueshëm dhe vullnetar.

ERSTE d.o.o. – shoqëri për promovimin e fondeve të pensionit të detyrueshëm dhe vullnetar menaxhon tre fonde pensionesh të detyrueshme dhe tetë fonde pensioni vullnetare në Kroaci

Grupi ERSTE nuk ka shoqëri të lidhura të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut:

Veprimtaria e regjistruar e Shoqërisë Lajthaus Investments, e cila është pronare e mjeteve që janë objekt i Transaksionit, është tregtimi me pasuri të paluajtshme.

Lajthaus Investments nuk ka shoqëri të lidhura të regjistruara në Maqedoninë e Veriut dhe as nuk ka realizuar qarkullim në tregun relevant në Maqedoninë e Veriut në vitin 2023.

Parashtruesi i njoftimit konsideron se tregu relavant për përqendrimin në fjalë mund të përcaktojë tregun e dhënies me qira dhe të punës me pasuri të paluajtshme vetjake ose me qira. Tregu përkatës gjeografik është tregu i Republikës së Sllovenisë.

*Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.*

*Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.*

15.08.2024

Shkup